



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.11.2025
Numër Protokolli: 8155/2025

A.nr.1201/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtar, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1201/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesi B.V, kundër organit të punësimit/Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “kërkesë nga nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A. Nr.1201/2025, të datës 24.06.2025, e parashtruar nga ankuesi B.V, ashtu që detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj Kërkesën e datës 20.05.2025 të parashtruar nga ankuesi B.V dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.V, (ne tekstin e mëtejme, ankuesi) me datë 24.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos përgjigjes të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në kërkesën e datës 20.05.2025 dhe 27.05.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës (tutje referuar AKKVP), ndërsa Këshilli më datë 30.01.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 4297/2025 të datës 24.06. 2025, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ; Vendimi për transferim i datës 23.12.2024; Vendimi për transferim i datës 15.05.2025; Kërkesa e datës 27.05.2025; Emali i datës 20.05.2025; E-mal i datës 18.04.2025; Vendimi A.nr.152/2025 i datës 24.03.2025 i KPMSHCK-së; Kopja e letërnjoftimit.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me kërkesën e datës 20.05.2025 dhe 27.05.2025 të parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 23.12.2011, ka ushtruar pozitën e punës “Zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale”, në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë në kuadër të AKKVP-së.

Zv. Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore të AKKVP-së, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit me Vendimin Nr.75/2024, të datës 23.12.2024, ka transferuar ankuesin në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë/Departamenti për Koordinim Regjional.

Ankuesi më datë 21.01.2025, ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 75/2024 të datës 23.12.2024 të zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, i cili pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe është tendencioz ngase sipas ankuesit ai është transferuar nga pozita zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale në pozitë Zyrtar i lartë për Koordinim Regjionale, ndërsa Këshilli i Pavarur mbikëqyrës përmes vendimit me numër A.nr.152/2025, të datës 03.03.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit duke anuluar Vendimi me Nr. 75/2024, i datës 23.12.2024, i zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, si dhe **piken e** Raportit të Ristrukturimit Ref.Nr.01809/20244 të datës 02.12.2024, në lidhje me propozimin për transferim të ankuesit, ndërsa, lëndën e ka kthyer në **rishqyrtim dhe rivendosije** tek organi i njëjtë Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahaskim të Pronës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronës ka nxjerr Vendim me numër 02/2025 të datës 15.05.2025, përmes së cilit ankuesin për shkak të ristrukturimit e ka transferuar në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Dëbime” në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Ankuesi, me datë 20.05.2025 përmes emailit i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me kërkesë lidhur me kompensimin e pagave retroaktive nga janari i vitit 2025 ndërsa kjo e fundit përmes përgjigjes së datës 26.05/2025 i ka kthyer përgjigje duke theksuar se citoj „ *Ashtu si jeni të informuar me Vendimit të KPMSHCK-së A.nr.152/2025, të datës 03.03.2025 nuk është vendosur asgjë lidhur me pagat retroaktive*”, nga rrjedhë se kjo e fundit në përgjigjen e saj në fakt nuk ka shqyrtuar dhe as nuk ka vendosur lidhur kërkesën e ankuesit.

Kundër përgjigjes së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër moszbatimit të Vendimi A.nr.152/2025 i datës 03.03.2025 i KPMSHCK-së gjegjësisht lidhur me mos kompensimin e pagave retroaktive nga janari i vitit 2025

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se meqë pala ankuese, respektivisht ankuesi më datë 20.05.2025 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit, atëherë lidhur me obligimin e organit publikë që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: “3. *Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar*”, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, **vendos për çështjen**, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës*”, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*”, dhe erdhi në përfundimin se në secilin rast kur institucioni punëdhënës në cilësi të shprehjes së autoritetit zyrtar kur zgjedh një çështje administrative apo shqyrton një kërkesë të palës lidhur me të drejtat apo detyrimet e tij, duhet të nxjerrë akt administrativ përmes të cilit vendos për çështjen e cila ka qenë objekt shqyrtimi, ndërsa në rrethanat e rastit konkret objekti shqyrtimi i procedurës së filluar administrative ka qenë kërkesa e datës 20.05.2025 e ankuesit për kompensimin e pagave retroaktive nga muaji janar i vitit 2025 ndërsa në konstatimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, përmes Përgjigjes së datës 26.05.2025 nuk ka vendosur lidhur me çështjen e iniciuar, veprim ky që bie ndesh me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përderisa sipas nenit 2 paragrafi 1 i të njëjtut ligj në secilin rast kur organ publik në realizimin e autoritetit publik është i obliguar të zbatojë dispozitat e LPPA-së kur vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, gjegjësisht organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri

me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën e datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përgjigjja ne kërkesë përmes emali, në këtë rast, zyrtarit përgjegjës të burimeve njerëzore në Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, në raport me ankuesin, gjegjësisht Kërkesën e datës 20.05.2025, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi kërkon realizimin e një të drejte, dhe se organi i punësimit ka qenë i obliguar të trajtoj kërkesën e tij të datës 20.05.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj zyrtarin përgjegjës të burimeve njerëzore, gjegjësisht Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën e datës 20.05.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1201/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, B.V;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.